REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA SHKODËR**

Nr. 26154 Prot Shkodër, më 22.10.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin për "Dhënie pëlqimi për pranimin e donacionit nga Fondacioni "Mane Foundation", për rikonstruksionin e ambienteve të brendshme dhe tualeteve të Shtëpisë së Fëmijës 0–5 vjeç, Shkodër."

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet Beci**

**Me Vendim Delegimi**
**Zv/Kryetar**

**Alban Preka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr._____ Prot Shkodër, më ____.____.2026

**PROJEKT- VENDIM**

**Nr._____, datë____.____.2026**

**PËR**
**"DHËNIE PËLQIMI PËR PRANIMIN E DONACIONIT NGA FONDACIONI "MANE FOUNDATION", PËR RIKONSTRUKSIONIN E AMBIENTEVE TË BRENDSHME DHE TUALETEVE TË SHTËPISË SË FËMIJËS 0–5 VJEÇ, SHKODËR"**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe nenit 24, pika 2, nenit 35, pika d, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; nenit 20, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ligjit nr.7892, VKM-së nr. 366, datë 27.03.2008, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër"; dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga administrata e Bashkisë.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënies së pëlqimit për pranimin e donacionit nga Fondacioni "Mane Foundation", në formën e punimeve të rikonstruksionit të ambienteve të brendshme dhe tualeteve të Shtëpisë së Fëmijës 0–5 vjeç, Shkodër, me vlerë të parashikuar 27,145.80 (njëzet e shtatë mijë e njëqind e dyzet e pesë euro e tetëdhjetë cent) euro, me TVSH.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**
**ZV/KRYETAR**

**ALBAN PREKA**

Zv. Kryetar

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

DIONIS SHEGANI

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

DORINA [illegible]

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit, Rinisë dhe Shëndetit Publik

Drejtoria e Aseteve dhe Kadastrës Urbane

VALDO DIBRA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr._____ Prot Shkodër, më ____.____.2026

**RELACION**

**"Dhënie pëlqimi për pranimin e donacionit nga Fondacioni "Mane Foundation", për rikonstruksionin e ambienteve të brendshme dhe tualeteve të Shtëpisë së Fëmijës 0–5 vjeç, Shkodër."**

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe nenit 24, pika 2, nenit 35, pika d, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; nenit 20, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"; ligjit nr.7892, VKM-së nr. 366, datë 27.03.2008, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër"; dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga administrata e Bashkisë.

Bashkia Shkodër, në ushtrim të funksioneve të saj, synon të zhvillojë dhe të përmirësojë shërbimet sociale në territorin e vet, duke garantuar mbështetje dhe kushte të përshtatshme për fëmijët, veçanërisht për fëmijët në situatë vulnerabiliteti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Fondacioni "Mane Foundation" është organizatë jofitimprurëse me karakter humanitar dhe filantropik, e cila mbështet veprimtari në dobi të interesit publik dhe social. Në kuadër të këtij

misioni, Fondacioni ka përzgjedhur Shtëpinë e Fëmijës 0–5 vjeç, Shkodër, si institucion përfitues të një projekti që synon përmirësimin e kushteve fizike të ambienteve ku ofrohen shërbimet për fëmijët.

Shtëpia e Fëmijës 0–5 vjeç, Shkodër, është institucion i kujdesit social në varësi të Bashkisë Shkodër dhe Shërbimit Social Shtetëror. Institucioni ofron shërbim rezidencial për 12 fëmijë të moshës 2–6 vjeç dhe shërbim ditor për 6 fëmijë të moshës 4–12 vjeç. Godina, e ndërtuar në vitin 1980, paraqet nevoja për ndërhyrje për shkak të lagështirës, amortizimit të rrjetit elektrik dhe gjendjes së disa ambienteve të brendshme dhe tualeteve.

Fondacioni "Mane Foundation" do të mbështesë rikonstruksionin e ambienteve të brendshme dhe tualeteve të Shtëpisë së Fëmijës 0–5 vjeç, Shkodër. Balfin Development SHPK do të përgatisë dhe dorëzojë projektin teknik, ndërsa Balfin Construction SHPK do të realizojë punimet e parashikuara sipas preventivit përkatës. Vlera e projektit teknik është 3,000 euro, përfshirë taksat dhe detyrimet përkatëse, ndërsa vlera e parashikuar e punimeve është 27,145.80 euro me TVSH. Vlera përfundimtare e punimeve do të përcaktohet sipas volumeve faktike dhe çmimeve për njësi të preventivit.

Pas përfundimit të punimeve dhe shlyerjes së pagesave përkatëse nga Fondacioni, punimet e realizuara do t'i dhurohen Bashkisë Shkodër si përfitues, për t'u përdorur në funksion të përmirësimit të kushteve të shërbimit për fëmijët. Dorëzimi do të dokumentohet me procesverbal, sipas kushteve të parashikuara në marrëveshjen përkatëse.

Fondacioni merr përsipër financimin e projektit teknik dhe të punimeve, përkatësisht në vlerën 3,000 euro për projektin teknik dhe me vlerë të parashikuar 27,145.80 euro me TVSH për punimet. Financimi do të kryhet drejtpërdrejt nga Fondacioni te Projektuesi dhe Sipërmarrësi; nuk parashikohet transferim fondesh në llogarinë e Bashkisë Shkodër.
Bashkia Shkodër, në cilësinë e përfituesit, do të mundësojë aksesin në ambientet ku do të kryhen punimet, do të bashkëpunojë gjatë zbatimit të projektit dhe do të marrë në dorëzim punimet e përfunduara, në përputhje me specifikimet teknike dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshje.

Më konkretisht, Fondacioni "Mane Foundation" angazhohet:

1. Të financojë përgatitjen e projektit teknik nga Balfin Development SHPK, në vlerën 3,000 euro, përfshirë taksat dhe detyrimet përkatëse.
2. Të financojë punimet e rikonstruksionit të realizuara nga Balfin Construction SHPK, me vlerë të parashikuar 27,145.80 euro me TVSH, sipas preventivit dhe volumeve faktike të punimeve.
3. Të bashkëpunojë me palët për realizimin e projektit, të marrë pjesë në proceset e dorëzimit dhe të kryejë pagesat përkatëse sipas afateve dhe kushteve të marrëveshjes.
4. Të mbështesë koordinimin dhe monitorimin e punimeve dhe, sipas marrëveshjes, të përballojë shpenzimet për lejet, tarifat dhe procedurat e nevojshme për realizimin e punimeve.

5. Të dhurojë në favor të Bashkisë Shkodër punimet e realizuara pas përfundimit të tyre dhe shlyerjes së pagesave përkatëse, në përputhje me kushtet e marrëveshjes.
6. Të sigurojë, së bashku me Sipërmarrësin, dokumentimin e dorëzimit të punimeve me procesverbal dhe trajtimin e të metave që mund të konstatohen gjatë dorëzimit, sipas parashikimeve të marrëveshjes.

**Bashkia Shkodër, në cilësinë e përfituesit, angazhohet:**

1. Të mundësojë vënien në dispozicion të ambienteve për kryerjen e punimeve, në koordinim me institucionin përfitues dhe palët e tjera.
2. Të bashkëpunojë dhe të koordinojë me Fondacionin, Projektuesin dhe Sipërmarrësin gjatë fazave të zbatimit të projektit, duke ndjekur realizimin e punimeve sipas projektit teknik dhe specifikimeve të dakordësuara.
3. Të marrë pjesë në procesin e verifikimit dhe të marrë në dorëzim punimet e përfunduara, nëse ato janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e marrëveshjes.
4. Të përdorë punimet e dhuruara në funksion të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe të kujdeset për mirëmbajtjen e ambienteve të rikonstruktuara.
5. Të përmbushë detyrimet e tjera që i ngarkohen në cilësinë e përfituesit.

Realizimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve fizike dhe të sigurisë së ambienteve ku ofrohen shërbimet për fëmijët në Shtëpinë e Fëmijës 0–5 vjeç, Shkodër. Pranimi i donacionit nuk parashikon transferim fondesh nga Fondacioni te Bashkia; pagesat për projektin teknik dhe punimet do të kryhen drejtpërdrejt nga Fondacioni te subjektet përkatëse, ndërsa punimet e përfunduara do t'i dhurohen Bashkisë.

Për sa më sipër, ju ftojmë të shqyrtoni dhe miratoni projekt-vendimin për dhënien e pëlqimit për pranimin e këtij donacioni.

**KRYETAR**

**Benet Beci**

**Me Vendim Delegimi**
**Zv/Kryetar**

**Alban Preka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit, Rinisë dhe Shëndetit Publik

Arlinda Kryeje